



PROCESVERBALI

Mbledhja e **Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB)** - Rahovec, e mbajtur më **14.8.2024**, me fillim në orën **15:10**. Mbledhjen e kryesoi kryetari i Komunës, **Smajl Latifi**. Për mbajtjen e mbledhjes kuorumi ekziston.

Kryetari: Më lejoni t'ju përshëndes anëtarët e KKSBB-së, drejtorët e drejtorive, nënkryetarin, komandantin e stacionit të policisë në Rahovec, Fazli Morina, përfaqësuesit e bashkësive fetare, përfaqësuesit e FSK-së, të shoqërisë civile, të bizneseve, të komuniteteve pakicë, OSBE-së, KFOR-it, LMT-së, zyrtarët komunalë dhe mediet. Është mbledhja e **pestë** e rregullt për vitin 2024. Për këtë mbledhje të rregullt, propozoj këtë:

Rend Dite

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit,**
 - Siguria në trafik;
 - Masat për parandalimin e lëmshërkësive;
 - Informatë dhe analizë nga policia e Kosovës për çështjen e vjedhjeve dhe të sigurisë së përgjithshme;
- 3. Informatë për fillimin e procesit mësimor 2024-2025 dhe çështja e sigurisë nëpër shkollë;**
- 4. Identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta;**
- 5. Vetëdijësimi i qytetarëve për mbrojtjen e pyjeve dhe të fushave nga zjarri, gjatë sezonit veror, si dhe mbrojtja nga dëmtuesit ilegalë;**
- 6. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat;**
- 7. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore;**
- 8. Të ndryshme.**

Kryetari: Nëse ka dikush ndonjë koment rreth rendit të ditës?... Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është “për”?... A ka votë kundër?... Faleminderit, pra mund të fillojmë takimin me këtë rend dite:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryetari: Besoj që e keni lexuar procesverbalin! A ka dikush vërejtje apo plotësime? Nëse jo, atëherë po e hedhim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash aprovohet procesverbalin.

2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit:

Kryetari: Në këtë pikë janë edhe nënpikat që janë në interes për t'u trajtuar në këtë takim: Siguria në trafik, masat për parandalimin e lëmshërkësive, informatë dhe analizë nga policia e Kosovës për çështjen e vjedhjeve dhe të sigurisë së përgjithshme. Ndërmjet dy mbledhjeve të KKSBB-së, në përgjithësi, situata ka qenë e qetë dhe stabile,

përkundër faktit që ka pasur ngarkesa dhe ka ende. Ka ardhur një numër i madh i bashkatdhetarëve tanë, duke e rritur qarkullimin e njerëzve në trafik, kuptohet edhe me aktivitete të shumta, të cilat kanë qenë të planifikuara për fazën e “Muajit të mërgimtarëve”. Vlen të ceket që parkingu ka qenë për bashkatdhetarët në oborr të komunës dhe po ashtu është bërë një sportel enkas për ta, për t’i kryer shërbimet më shpejt dhe më lehtë. Është fat shumë i mirë që në punishten e sheshit qendror janë krijuar disa mundësi të përkohshme, që qytetarët tanë i kanë shfrytëzuar për parking.

Fazli Morina: Faleminderit, kryetar! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë! Kryetari e tha që nga takimi i fundit i KKSB-së e deri më tani, situata në mbarë zonën e përgjegjesisë është e qetë dhe stabile. Kemi pasur shumë plane operative, shumë kërkesa, shumë asistime dhe falë angazhimit të të gjithëve është arritur të menaxhohet situata dhe të ketë rend dhe siguri për të gjithë qytetarët. Aktivitetet policore vazhdojnë të bazuara në të gjitha dokumentet strategjike. Janë implementuar dhe vazhdojnë të implementohen 18 urdhëresa operative, 8 plane operative, 9 plane të veprimit dhe 2 projekte. Kanë qenë 92 vepra penale të iniciuara, 89 incidente penale dhe 3 incidente jopenale. Nga të gjitha këto, 1 rast detyrim për prostitucion, 1 rast për shitje të narkotikëve, 1 rast sulm ndaj personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare, 8 raste të falsifikimit të parasë, 2 vjedhje të rënda, 3 raste ndotje të mjedisit, 3 raste të asgjësimit të pajisjeve mbrojtëse në vendin e punës, 7 raste për armëmbajtje pa leje, 1 rast është “armë e gjetur”, 7 raste të dhunës në familje, 1 rast është gjetja e mjeteve mortore në fshatin Kramovik – është gjetur një kafkë dhe vazhdohet me procedura tutje. Janë 67 urdhëresa të gjykatës, 37 persona janë arrestuar, 25 prej tyre janë ndalur për 48 orë. Te lëmoshëkërkuesit jemi duke e bërë të pamundurën edhe në bashkëpunim me institucionet e tjera dhe lirisht mund t’ju them që numri i tyre në qytetin e Rahovecit është shumë i vogël. Sa i përket sigurisë në komunikacion, jemi në vazhdim të implementimit të disa planeve operative. Gjatë kësaj periudhe janë këto statistika: janë shënuar gjithsej 1338 gjoba për kundërvajtje në komunikacion rrugor, 23 gjoba për drejtim të automjetit pa patent-shofer, 18 - vazhdimi i masës së ndalimit të vozitjes, 208 janë për parkingje ilegale, 15 për përdorim të telefonit gjatë drejtimit të automjetit dhe 7 gjoba për prishje të rendit dhe të qetësisë publike. Për shkak të fluksit të madh në komunikacion janë 30 aksidente me dëme materiale, 36 janë me lëndime dhe për fat të keq një aksident me fatalitet, me motoçikletë. Gjatë kësaj periudhe kanë qenë patrullime të shtuara rreth objekteve fetare ortodokse serbe, siç janë: manastiret, kishat ortodokse, varrezat dhe vendbanimet. Gjatë kësaj kohe janë realizuar 1287 patrullime. Siguria në shkollë: edhe pse në pushim, janë të raportuara dy raste: dëmtimi i pasurisë në Ratkoc, në Shkollën “Katër Dëshmorët”, një rast tjetër ka ndodhur në çerdhen e fëmijëve “Tulipanët” në Rahovec, vepra quhet “cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe të objekteve”. Janë realizuar 16 kontakte dhe vizita në shkollë, 292 patrullime afër shkollave dhe 11 pika kontrolli.

Kryetari: Faleminderit, komandant! Nëse dikush ka diçka për të thënë? Nëse jo, atëherë dua t’ju them që të rrimë të angazhuar së paku edhe disa ditë, për shkak të qarkullimit të madh të makinave dhe të numrit të madh të bashkatdhetarëve, në mënyrë që të kemi sa më pak sfida para vetes. Gjatë kësaj kohe, kemi pasur sfida me furnizim me ujë të pijshëm. Ka përmirësime në këtë drejtim, por ka edhe sfida që ndërlidhen me mungesa të caktuara të kompanisë publike rajonale të ujësjellësit “Gjakova”. Ka pasur sfida me kanalizim të ujërave të zeza, sidomos në ato segmente ku kanalizimi ka qenë i vjetër. E kemi rritur presionin që të kemi zgjidhje sa më të mira dhe sa më efikase në këtë drejtim.

3. Informatë për fillimin e procesit mësimor 2024-2025 dhe çështja e sigurisë nëpër shkollë:

Kryetari: Për arsye objektive, me leje, mungon drejtori i DKA-së. Ju njoftoj që janë duke u bërë përgatitjet e nevojshme për një fillim të mbarë të vitit të ri shkollor. Janë duke ndodhur investime në plot objekte shkollore me eficiencë të energjisë dhe qofshin edhe brenda shkollave, me nyje sanitare. Janë edhe tri çerdhe të tjera të reja që do të fillojnë punën, pas inventarizimit dhe njëkohësisht do të rritet numri i fëmijëve, bashkë me një personel të nevojshëm. Janë duke u vendosur edhe kamera dhe në qytet pothuajse janë funksionalizuar të gjitha, si dhe janë duke u vendosur kamera të reja edhe në shumë pika të tjera, që do ta ndihmojnë mirëmbajtjen e sigurisë jo vetëm

në shkolla, por edhe në komunën tonë në përgjithësi. Një paqartësi qëndron rreth librave dhe teksteve dhe është duke u pritur të ndodhë subvencionimi i prindërve, 80-100€, varësisht nga klasat. Pra, është viti i dytë që është një paqartësi. Kjo është direkt përgjegjësi e ministrisë dhe nuk e di pse po përsëritet e njëjta gjë edhe këtë vit. Autoritetet komunale, përkatësisht DKA-ja, i ka bërë të gjitha përgatitjet me kohë dhe procesin mësimor do ta fillojmë mbarë.

4. Identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta:

Kryetari: Ju informojmë që në çdo projekt publik është e paraparë të bëjmë shënjimin i hapësirave që sigurojnë qasje të lehtë të qytetarëve me nevoja të veçanta. Kjo nuk parashihet vetëm në planin e investimeve publike, por edhe te investitorët privatë. I rekomandojmë të gjithë ata që ndërtojnë afër rrugëve rajonale dhe lokale, duhet ta kenë parasysh faktin që është obligative që të kenë hapësira të nevojshme për qasje të qytetarëve me nevoja të veçanta në objekte, në rrugë, në hapësira, në trotuare etj. Një nga arsytet e vendosjes së ashensorit në objektin e komunës është edhe qasja e qytetarëve që kanë nevoja të veçanta, deri në katin e tretë.

Lulzim Krasniqi: Përshëndetje, kryetar! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Sa i përket kësaj pike, lidhur me lehtësimin e kyçjes së personave me aftësi të kufizuara nëpër institucione, si private ashtu edhe publike, dua të ndërlihem dhe që është normale të ekzistojnë kriteret mbi të cilat pranohet një punim i një ndërtese apo i një objekti. Pse nëpër shkolla trikatëshe nuk ka ashensor? Në Krushë, në Rahovec. Realisht, Shkolla “Isa Boletini” ka mbi 15 persona me nevoja të veçanta, që mund të ketë vështirësi lidhur me kyçjen në klasa.

Kryetari: Është e vërtetë që objekteve shkollore iu mungon ashensori. Në shkolla, ku i kemi njerëzit me nevoja të veçanta, primare është t’i vendosim në katin e parë. Përveç QKMF-së dhe tani që është duke u vendosur në komunë dhe çerdhes së fëmijëve në Ratkoc, nuk kemi ashensorë në objekte të tjera. Me patjetër që do të duhej të kishte, por deri sa të bëhen, duhet të jetë një kujdes më i madh nga drejtorët e shkollave apo edhe nga zyrtarët kompetentë, sepse e kemi obligim moral dhe ligjor që t’iu krijojmë qasje qytetarëve me nevoja të veçanta. Këto sfida ndërlihen edhe me buxhet, sepse nëse nuk ka ashensorë, edhe mund të bëhen.

5. Vetëdijesimi i qytetarëve për mbrojtjen e pyjeve dhe të fushave nga zjarri, gjatë sezonit veror, si dhe mbrojtja nga dëmtuesit ilegalë:

Besmire Bytyqi: Faleminderit, kryetar! I nderuar kapiten i stacionit policor, anëtarë të KKSB-së! Kjo verë ka qenë e jashtëzakonshme me temperatura të larta. Nga 1 korriku deri më sot, njësia e zjarrfikësve ka intervenuar në 94 raste të zjarreve, që për qytetin tonë është një numër jashtëzakonisht i madh. Vlen të theksohet që për shuarjen dhe për lokalizimin e tërësishëm të këtyre zjarreve, zjarrfikësit tanë kanë punuar mbi 500 orë, me terrene jashtëzakonisht të vështira dhe në temperatura shumë të larta. Në ndihmë, në disa raste, na kanë dalë edhe autoritetet e pyjeve, si dhe Drejtoria për Bujqësi. Shfrytëzoj rastin ta falënderoj edhe policinë e Kosovës për mbështetjen në këtë situatë! Zjarret po vazhdojnë ende. Qytetarët e pandërgjegjshëm, me ose pa qëllim, po shkaktojnë djegien e dhjetëra hektarëve, duke shkaktuar probleme mjedisore dhe probleme për florën dhe për faunën. Njësia e zjarrfikësve në Rahovec, numëron vetëm 17 zjarrfikës, duke përfshirë këtu edhe komandantin e njësisë. Nga numri jemi shumë pak, sepse ndonjëherë kemi pasur raste kur i kemi dy apo tri vatra aktive në të njëjtën kohë. Kërkoj ndihmën tuaj si anëtarë të KKSB-së dhe të qytetarëve të Rahovecit, që të na ndihmoni duke përçuar mesazhe për mosndezje të zjarreve, për lajmërim me kohë, si dhe me mundësitë e tyre, të na ndihmojnë edhe në fikjen e zjarrit, sepse kemi nevojë edhe për vullnetarë. Para sezonit, kemi bërë fushata vetëdijesuese me zjarrfikësit, me drejtorinë, në faqen zyrtare të komunës, kemi biseduar me persona individualisht dhe me fëmijë nëpër shkolla. Uroj shumë që ne do të bashkëpunojmë dhe viteve të ardhshme të mos kemi zjarre të shumta!

Kryetari: Faleminderit, Besmire! Ndoshta edhe tani përderisa po flasim ka zjarre dhe zakonisht bisedat me komandantin janë që ka edhe pakujdesi të qytetarëve. P.sh. duhangjijntë nuk e kanë problem që nga makina ta hedhin cigaren dhe prej asaj gace bëhet “sherri”. Ka shumë nevojë të kemi vetëdijesim më të lartë për raportim të qytetarëve në numrat kompetentë, sepse kemi shumë dëme edhe në ekonominë pyjore. Si komunë nuk jemi logjistikë e dobët, por, 17 zjarrfikës në temperatura të larta mbi 40, nuk mund t’i mbulojnë të gjitha situatat e

paraqitura. Ju ftoj të kontribuoni më shumë dhe të lajmëroni policinë! Po digjet Prevalla, Pashtriku, Bjeshkët e Sharrit, nuk e di, sikur me qenë ndonjë skenar i natyrës së armiqve, që të na zhveshë nga kjo pasuri natyrore që e kemi. Nuk qëndron kjo që e potencova, por, ne nuk është mirë që ne në mungesë të veprimit “ta çojmë ujin nëpër mullinj” të atyre që mund të kenë skenarë që Kosova mos të ketë pyje, pasuri dhe begatitë që i kemi.

Fazli Morina: Faleminderit, drejtoreshë, për të gjitha angazhimet e bëra! Për vatrat e zjarrit jemi të obliguar të raportojmë në qendrën në Prishtinë për zonën tonë të përgjegjësisë. Për momentin, gjatë ditës nuk ka zjarre. U përmendën kamerat nga kryetari dhe besoj që “kamera” mund të jemi të gjithë në që jemi këtu prezentë, bashkë me të gjithë qytetarët e tjerë. Mbështetja dhe përkrahja me informata nga qytetarët është shumë e vogël. Në aspekt moral duhet t’i kontribuojmë vendit për një rend normal, që edhe mos ta kemi asnjë vatër të zjarrit. Qëndrojmë shumë më mirë edhe nga zjarret, nëse Komunën e Rahovecit e krahasojmë me komunat e tjera.

Kryetari: Faleminderit, komandant! E lus Përparimin të flasë pak rreth mbeturinave dhe ujërave të zeza, dhe për pikën e shtatë Nora Boshnjaku.

6. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat:

Përparim Krasniqi: Faleminderit, kryetar! Përshëndetje për të gjithë anëtarët e pranishëm! Ju njoftoj që, zyrtarisht, javën e kaluar, kryetari i Komunës ka lidhur një kontratë me BE-në. Është një projekt i fituar për vendosjen e gropave septike, projekt ekologjik dhe që i mundëson Komunës së Rahovecit që në ambientet ku derdhen ujërat e zeza të jetë i pastër. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Inspektoratit, po kujdesemi të menaxhojmë edhe deponitë ilegale në territorin e komunës sonë, sidomos në rrugët rajonale. Momentalisht, gjendja është e pastër, por, fatkeqësisht, kemi shumë raste që mbeturinat inerte dhe të përziëra hedhen në vende, ku hedhja është rreptësisht e ndaluar. Është mirë që përmes këtij kuorumi, kur hasim raste të tilla, t’i lajmëroni policinë apo inspektoratin.

7. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore:

Nora Boshnjaku: Faleminderit, kryetar! Përshëndetje për të gjithë anëtarët e KKSB-së! Sa i përket mbrojtjes së lumenjve, të gjithë jemi të vetëdijshëm që kemi një sfidë të madhe në mbrojtjen dhe degradimin e lumenjve nga keqbërësit, më saktësisht nga operatorët legalë dhe ilegalë, si dhe nga faktori njeri. Kemi pasur disa denoncime nga inspektorati ynë komunal, po ashtu, në koordinim me njësitin për hetimin e krimeve mjedisore, konkretisht në kuadër të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve të Rënda, janë organizuar disa aksione për sekuestrim të makinerive që kanë bërë tërheqjen e zhavorrit në mënyrë ilegale, por edhe legale. Deri më tani, për ndotje të mjedisit janë shqiptuar 47 gjoba nga inspektorët tanë komunalë. Mos të harrojmë, ne operojmë vetëm me një inspektor të mjedisit, mirëpo, me autorizimin edhe të inspektorëve të tjerë, ka arritur të shqiptohet ky numër i gjobave. Denoncimet nga qytetarët janë të pakta, mos të themi zero. E kam potencuar disa herë që nuk jemi kompetentë për dënime në kuadër të sigurisë së produkteve ushqimore, por, kemi pasur një bashkëpunim me inspektoratin sanitar dhe janë denoncuar dy raste për helmim të dy qytetarëve të komunës sonë, në dy prej supermarkete të Komunës së Rahovecit. Në vazhdim të javës do të merren edhe disa aksione të tjera në bashkëpunim me inspektoratin sanitar për kontrollimin e afateve në produkte të caktuara ushqimore. Për këtë periudhë raportuese, në Komunën e Rahovecit, janë shqiptuar 137 gjoba, me vlerë mbi 30.000€, jo vetëm për mjedis, por, për çdo shkelje të bërë.

Kryetari: Faleminderit! Ne vazhdojmë ta kemi prioritet të lartë edhe mbrojtjen e mjedisit, për një mjedis pa mbeturina. Do të ndërtohet gropat septike në gjashtë pika, të cilat e bëjnë përpunimin dhe filtrimin e ujërave të zeza dhe 70% i nxjerrin si ujëra të bardha. Një gropë septike kushton mbi 36.000€, fondi është i BE-së dhe ne jemi në partneritet me Komunën e Haraqinës me 200.000€. Një do të jetë në qytet, do të ketë në Pastasel, Gur të Kuq, Pataqan dhe me një kontratë tjetër i kemi 6 të tjera. Besojmë që do të kontribuojmë në mbrojtjen e lumenjve, të përrenjve dhe të mjedisit në përgjithësi, përmes funksionalizimit të këtyre gropave septike të standardeve të larta. Ne e inkurajojmë inspektoratin që të vazhdojë me masa konkrete dhe intensive në mbrojtje të mjedisit. Kemi nevojë t’i luftojmë mbeturinat që janë si mbetje shtazore, që zakonisht po hidhen nëpër brigje të lumenjve, në lugje e në

kodra. Të ketë një kujdes të shtuar në ushqimet me afat të skaduar, sidomos te mishit dhe te prodhimet e tjera, këtu bëjnë pjesë edhe barnat. Duhet ta kemi një vetëdijesim për raportimin e këtyre rasteve.

8. Të ndryshme:

Shaip Shala: Faleminderit, i nderuari kryetar! Do të diskutoj për pikën e parë të kësaj liste, rreth transportit të kufomave deri te varrezat. Këtë temë nuk e kam diskutuar më herët, sepse nuk kam pasur rast. Pres që kontributin e duhur do ta japë edhe hoxhë Nysreti. Këtu po shkruan: transporti i kufomës brenda territorit të komunës së Rahovecit, bartja e kufomës nga shtëpia deri në xhami – 35 €. Këto mjete dhe më shumë se kaq, paguajmë ne familjarët. Qytetarët nuk e kanë këtë listë, sigurisht. Nga sot do ta kenë nga unë, prej fejsbukut.

Kryetari: Shaip, të respektoj për faktin që je më i vjetër dhe që je aktivist i hershëm sportiv. Nëse më lejon, këtë gjë do ta bisedojmë bashkë jashtë. Nëse ke edhe diçka tjetër?

Shaip Shala: Gjithashtu, këtu nuk figuron thirrja e sallës. Sipas logjikës, thirrja e sallës është gjithashtu shërbim mortor. Mendoj që ky çmim është shumë, bile të ketë pak respekt për të vdekurit. Për tri fjali, 15€!

Kryetari: Faleminderit Shaip! Inshallah keni jetë të gjatë. Sallën mund të shkosh ta porositësh, por, mund edhe të mos shkosh hiç! E kam pak për relaks dhe jo në ndonjë dimension tjetër.

Nysret Abazibra: Edhe unë pajtohem me kryetarin dhe këtë çështje do ta sqaronim shumë qartë, me 2-3 fjalë. Meqenëse u ngrit si temë: sa i përket transportit brenda qytetit dhe që 35€ i ofron komuna është e saktë dhe nuk ka mundësi që dikush ka marrë pagesë ekstra jashtë kësaj. Mirëpo, ka kërkesa ekstra nga familjarët që kërkojnë që, përveç transportit prej shtëpisë në varreza, kërkojnë gjithashtu që ta marrin në shtëpi, ta dërgojnë në morg dhe prej morgut përsëri në shtëpi, si dhe më pas të shkojnë në xhami, teqe apo te varrezat. Ata që kërkojnë këtë shërbim, është normale që ne duhet ta angazhojmë shoferin dhe i kemi shpenzimet tona dhe nuk është 35€, por 25€. Sa i përket sallës, salla është falas, përveç atyre që nuk paguajnë anëtarësi. Dhashtë zoti mos të vdesim asnjëri nga ne, po nuk kemi “qare” pa vdekur.

Shaip Shala: Mu për këto gjëra, pagesa çpagesa e kam marrë specifikimin se sa kam borxh dhe mirë që nuk ishte borxhi i madh. Do të vazhdoj të paguaj.

Kryetari: Familjarët e të vdekurit, kur hoxha e këndon sallën, ia japin prej shpirtit ndonjë “bakshish” dhe nuk është që hoxha ia kërkon. Kjo bëhet për respekt dhe për nder. Në të ardhmen, shërbimeve do t’u rritet vlera dhe avancimi. Ju falënderoj të gjithëve për bashkëpunimin dhe për punën e bërë!

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

Kryetari i Komunës

Smajl Latifi

